



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 28, datë 24.03.2020**

**“PËR  
KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE  
SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË  
STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË  
INFEKSIONIT COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin Social”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Urdhrit nr. 132, datë 08.03.2019 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, Urdhrit nr. 156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, Aktit Normativ nr. 4, datë 16.03.2020 “Për disa shtesa të Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

**1.** Në kuadër të marrjes së masave për lehtësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni COVID -19, për t’iu dhënë mundësinë të qëndrojnë në shtëpi dhe të mos humbasin afatet e aplikimit nga programet sociale të ofruar nga Bashkia Tiranë:

**a)** Të shtyjë afatin e aplikimit të muajit Mars të fazës së parë për programin social të strehimit “Subvecioni i qirasë”, deri në datën 10 prill 2020.

**b)** Të shtyjë afatin e aplikimit për të përfutuar nga programi “Subvencionimi i interesave të kredisë” deri në datën 17 Maj 2020.

**2.** Lehtësimin e barrës fiskale për biznesin, duke vendosur:

**a)** Përrjashtimin nga pagesa e shfrytëzimit të tarifës së zënies të hapsirës publike për muajin Mars-Prill 2020.

**b)** Shtyrjen e afatit të kështit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore, nga muaji Prill për në

fund të muajit Qershor 2020.

c) Shtyrjen e afatit të kështit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të muajit Qershor për në fund të muajit Gusht 2020.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësitë Administrative/Lagjet, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**